

**UNIVERISITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT**



**PUNIM DIPLOME
MASTER**

Tema:
**DALLIMI I KARAKTERISTIKAVE MORFOLOGJIKE
DHE AFTËSIVE MOTORIKE MES MUNDËSVE TË KOSOVËS
DHE MAQEDONISË SË VERIUT**

Mentori:
Prof.dr. Ajvaz Berisha

Kandidati:
Edon Shala

Prishtinë, 2020

PËRMBAJTJA

<u>Nr.</u>	<u>Emërtimi</u>	<u>Faqja</u>
1.	<i>HYRJE</i>	4
2.	<i>DISA HULUMTIME TË DERITANISHME</i>	5
3.	<i>QËLLIMI I HULUMTIMIT</i>	8
3.1.	<i>Hipotezat themelore</i>	8
4.	<i>METODA E HULUMTIMIT</i>	9
4.1.	<i>Mostra e entiteteve</i>	9
4.2.	<i>Mostra e ndryshoreve</i>	9
4.2.1.	<i>Ndryshoret antropometrike</i>	10
4.2.2.	<i>Ndryshoret motorike specifike</i>	10
5.	<i>METODAT E PUNËS</i>	11
5.1.	<i>Kushtet, instrumentet dhe teknikat e matjeve</i>	11
5.1.1.	<i>Instrumentet matëse</i>	11
5.2.	<i>Matjet e karakteristikave antropometrike</i>	12
5.3.	<i>Matjet e aftësive motorike</i>	14
5.4.	<i>Metodat për përpunimin e rezultateve</i>	19
6.	<i>REZULTATET DHE DISKUTIMI</i>	20
6.1.	<i>Parametrat themelor statistikor</i>	20
6.1.1.	<i>Analiza e parametrave themelor të ndryshoreve antropometrike të grupi A</i>	20
6.1.2.	<i>Analiza e parametrave themelor të ndryshoreve motorike specifike të grupi A</i>	21
6.1.3.	<i>Analiza e parametrave themelor të ndryshoreve antropometrike të grupi B</i>	22
6.1.4.	<i>Analiza e parametrave themelor të ndryshoreve motorike specifike të grupi B</i>	23
6.1.5.	<i>Paraqitja e mesatareve aritmetike mes grupeve</i>	26
6.1.6.	<i>Paraqitja grafike e parametrave antropometrik</i>	27
6.1.7.	<i>Paraqitja grafike e parametrave motorik</i>	28
6.2.	<i>Ndërlidhjet (korrelacionet) ndërmjet ndryshoreve</i>	29
6.2.1.	<i>Korrelacionet ndërmjet ndryshoreve antropometrike të grupi A</i>	29
6.2.2.	<i>Korrelacionet ndërmjet ndryshoreve antropometrike të grupi B</i>	30
6.2.3.	<i>Korrelacionet ndërmjet ndryshoreve motorike të grupi A</i>	33
6.2.4.	<i>Korrelacionet ndërmjet ndryshoreve motorike të grupi B</i>	34
6.2.5.	<i>Korrelacionet ndërmjet ndryshoreve antropometrike dhe motorike të grupi A</i>	35
6.2.6.	<i>Korrelacionet ndërmjet ndryshoreve antropometrike dhe motorike të grupi B</i>	36

7.	<i>ANALIZA E T - TESTIT</i>	38
7.1.	<i>Rezultatet e t – testit mes sportistëve të grupi Adhe grupi B</i>	38
7.1.1.	<i>Paraqitja grafike e rezultateve antropometrike në mes të sportistëve të grupi A dhe grupi B</i>	39
7.1.2.	<i>Paraqitja grafike e rezultateve motorike në mes të sportistëve të grupit Adhe grupi B</i>	40
7.2..	<i>Analiza e hipotezave</i>	49
9.	<i>PËRFUNDIMI</i>	50
10.	<i>LITERATURA</i>	52

1. HYRJE

Ky punimi është hartuar kryesisht në bazë të grumbullimit të informative nga dy grupet e sportistëve të ekzaminuar, grupin e parë e kanë përbërë sportistët mundës nga Kosova, kurse grupin e dytë e kanë përbërë sportistët mundës nga Maqedonia e Veriut. Çdo grup është përbërë nga 30 sportistë të moshës 18-25 vjeç. Fillimisht gjatë punimit janë analizuar mirë të gjitha informatat e mbledhura dhe vetëm pastaj punimi ka marrë formën e duhur. Punimi është punuar në programin Word, është shkruar me stilin Times New Roman me shkronja 12 - she, ndërsa kapitujt janë shkruar me shkronja 14 - she, në stilin Times New Roman Bold. Punimi gjithsej përmban 9 kapituj dhe 28 nënkapituj të punuar në formatin A/4, dhe gjithsej ka 44 faqe. Testimi i individëve është bërë me metodat më bashkëkohore dhe ato janë bërë nga profesorët e edukatës fizike. Dukuritë lëvizore janë në vartësi të ndikimit të shumë faktorëve, jo vetëm të natyrës motorike dhe teknike, por edhe atyre morfologjike, funksionale, sociale dhe psikologjike, të cilët i japin asaj karakteristikat e duhura sasiore dhe cilësore, në hapësira të pakufizuara dhe shumëdimensionale, që ndryshe quhen hapësira manifestuese motorike. Klasifikimi dhe përcaktimi i saktë i këtyre hapësirave edhe sot, paraqitet si një proces i vështirë, të cilit i janë kushtuar mjaft studime specifike. Qëllimi kryesor i të cilëve është i orientuar kryesisht në zbulimin e lidhjeve ndërmjet aftësive motorike dhe aspekteve tjera të personalitetit të njeriut gjatë veprimeve të organizuara dhe pikësnyimeve, duke pasur për bazë përvojat empirike si dhe përjasjet shkencore në fushat fenomenologjie dhe funksionale të dukurive lëvizore. Vrapimet, si dhe kërcimet e ndryshme, janë forma natyrale të lëvizjes, në tërësi. Këto lëvizjes përbëjnë një nga mjetet bazë të përgatitjes së gjithanshme të njeriut me pikësynim për arritje të larta sportive. Ky hulumtim përqendrohet kryesisht në treguesit e forcës eksplozive, shpejtësisë dhe qëndrueshmërisë specifike, vetëm atëherë, kur ato bashkërendohen me një shumëllojshmëri ushtrimesh të karakterit të përgjithshëm, mbi bazën e kombinimit adekuat të detyrave si dhe ngarkesës stërvitore, në kuadrin e mësimave stërvitore japin rezultate të dëshirueshme.

Rezultati kulmor është synim i secilit sportiest çoftë në garat vendore apo ato ndërkombëtare. Arritja e rezultateve kulmore është proces i vështirë dhe i mundimshëm, në rend të parë ajo është e ndërlidhur me shumë faktorë të ndryshëm, përgatitja e lartë,

kondicionale, mendore dhe ekzekutimi i përsosur e me përpikmëri i elementeve të mundjes bëjnë që mundësi të ketë përparësi ndaj kundërshtarit.

Mundja është sport i ngarkesave të mëdha dhe intenzitetit të lartë, ku mundësi përpiçet që kundërshtarin e vet në kuadër të rregullave me çdo kusht ta mundë. Për ta arritur një gjë të tillë nga mundësi kërkohet të ketë përgatitje të lartë fizike (Horvat, 1981, Thomas , 1989).

Lufta garuese në mundje zgjatë tri pjesë nga 3 minuta të kohës aktive. Ajo prezanton ngarkesë intensive shumë të lartë të tipit anaerob. Sistemi anaerob siguron energji të shpejtë dhe të shkurtër, për forcën eksplozive maksimale gjatë garës, përderisa sistemi aerob kontribon në aftësitë e mundësit që të përballoj lodhjen gjatë kohëzgjatjes së garës dhe të çlodhet gjatë periudhave të pushimeve të shkurtëra (Franchini, 2003).

Përgatitja specifike ndikon drejtëpërsëdrejti në zhvillimin e aftësive funksionale dhe atyre motorike që janë të domosdoshme për ekzekutimin e lëvizjeve specifike në sportin e mundjes.

Zgjedhjen e duhur të ushtrimeve specifike të mundësve dhe përsosshmëria e elementeve dhe lëvizjeve specifike është shumë me rëndësi për suksesin e mundësit, ngritja e aftësive motorike në nivelin kulmor dhe përgatitja kondicionale janë faktorë tjerë që e ndihmojnë mundësin në arritjen e qëllimit të tij për rezultat të mirë.

Testimi fiziologjik zakonisht bëhet për të vlerësuar nivelin e përgjithshëm të sportistit dhe gatishmërinë për të përcaktuar kahjet individuale të trajnimit, shikuar nga pikëpamja fiziologjike kapaciteti anaerob, forca dhe kapaciteti aerob janë llogaritur ndër karakteristikat kryesore që mundësi ka nevojë për ti zhvilluar.

Disa hulumtime kanë treguar se te mundësit që marrin pjesë në niveleve të ndryshme të garave, vërehen dallime të dukshme në përgatitjen fizike krahasuar me të tjerë.

1.1. Historiku i sporti i mundjes

Sporti i mundjes është ndër sportet më të hershme që njih njerëzimi, ky sport daton qysh para 5000 vitesh, ku hasen gjurmët me portrete të mundësve të cilat gjenden në varrezat e lashta të Faraonëve sundimtar egjiptas, ku janë paraqitur duke bërë mundje, pastaj ato hasen edhe te populli i lashte Grek, që edhe sot ruhen shumë skulptura , portrete, dhe shënime të shumta për sportin e mundjes.

Mundja ka qenë edhe njëra ndër 5 sportet kryesore që kanë mbretëruar gjatë zhvillimit të lojërave olimpike antike. (3)

Për këtë sport kanë folur edhe shumë filozof të vjetër antik, të cilët i kanë dhënë rëndësi shumë të madhe paraqitjes dhe domethënie që ka pasur në atë kohë sporti i mundjes, si dhe reputacionin që e gëzonte atëherë.

Edhe me themelimin e lojërave moderne olimpike sporti i mundjes ishte ndër sportet e para që është përfshirë në këto lojëra, edhe sot ky sport vazhdimisht është pjesë përbërëse e lojërave moderne olimpike.

Në Kosove, dhe në trojet tjera shqiptare ky sport vazhdimisht ka qenë prezent, ai është zhvilluar, në formën e garave të pehllivanëve, që daton qysh nga koha mesjetare, kurse si mundje moderne është përfshirë edhe në familjen e lojërave Olimpike.

Në Kosovë ky sport modern daton nga viti 1977, fillimisht me këtë sport janë marrë ekipet e para nga Suhareka dhe Prishtina. (2)

Mundja është sporti më i suksesshëm shqiptar, në garat ndërkombëtare, mundësit që e kanë përfaqësuar vendin tonë në evenimentet me të rëndësishme, kanë grumbulluar medalje duke filluar nga ato ballkanike, mesdhetare, evropiane, botërore, dhe deri te ato më të çmuara, të Lojërave Olimpike.

Sporti i mundjes bënë pjese ne grupin e sporteve mundëse, polistrukturale aciklike, ku kërkohet një përgatitje e lartë fizike dhe tekniko-taktike, si dhe një shkathtësi shumë e lartë, konative dhe kognitive, pastaj aftësi kooperuse, sociale, dhe tolerance maksimale sportive dhe inteligjencë shumë të lartë. (3)

Mundja është ndër sportet më të vjetra që njih njeriu. Mundja e ka përcjell zhvillimin e njeriut nëpër të gjitha periudhat e zhvillimeve shoqërore dhe ekonomike, me një fjale ishte shoqëruese e njeriut në të gjitha aktivitetet e tij. Para se të futemi në zhvillimin e mundjes së pari duhet të dimë se çka është fjala MUNDJE dhe cili është

qëllimi kryesor i sportit të mundjes. Fjala mundje ose, me e mund dikë, çoftë me rregulla sportive ,apo me ato popullore, nënkupton, vendosjen e individit apo personin e caktuar me të dy shpatullat njëkohësisht ne tapetin e mundjes, ose në tokë në mundjen popullore. (3)

Kundërshtarin në mundje duhet ta mbajmë 3 sekonda në tapet me të dy shpatullat dhe pastaj ndeshja quhet fituar. Pos shenjave apo simboleve të para, të gjetura nga njeriu që ka lënë gjurmët e veta në organizime, çofshin ato primitive, ose pak më shumë të organizuara, mundja është ndër aktivitetet e para sportive të argumentuara sidomos në varret e lashta të Faraonëve të Egjiptit.

Me zhvillimin historik të njeriut fillon të lind nevoja për t'u marrë më aktivitete të ndryshme, të motivuara nga instinktët, e më vonë edhe të menduara nga vet njeriu. Kështu që pos atletikës, harkut dhe hedhjes së shtizës, aktivitete këto të cilat ishin të domosdoshme për të ekzistuar nga gjenerata në gjeneratë, mundja ishte aktiviteti më i rëndësishëm menjëherë pas këtyre disiplinave. Argumentet apo faktet e sportit të mundjes janë te ruajtura edhe në Greqinë e vjetër antike, e më vonë edhe në perandorinë romake, ku edhe bëhet ndarja e mundjes në dy forma; në atë klasike dhe të lirë. Mundja është ndër sportet më të vjetra që ka njohur njeriu. Të flitet për mundje në kohën e Greqisë së lashtë ,që kishte një periudhë të pa imagjinueshme të zhvillimit të shkencave shoqërore dhe të atyre shkencore është e tepërt, dihet se mundja në lojërat e vjetra Olimpike ishte sporti më i lavdishëm dhe me më së shumti reputacion të asaj kohe. Për rëndësinë dhe tretmanin që i është kushtuar këtij sporti të lashtë, po i sjellim në kujtesë thënjet dhe mendimet e asaj kohe, të cituara nga nivelet aristokrate të asaj kohe, si dhe të filozofëve të ndryshëm. (3)

Nga njerëzit më me reputacion të asaj kohe ishte edhe filozofi i njohur PLATONI, i cili ka qenë edhe vet mundës edhe pse më vonë e mohonte se ishte marrë me këtë sport. Në atë kohë shumë njerëz të pasur kishin nga një teren të mbushur me rërë, me standarde të asaj kohe për të bërë mundje, dhe për të treguar se janë të niveleve të larta aristokrate, si dhe për t'u treguar se janë në trendin e kohës, ata lavdëroheshin me këto shprehje: Unë e kamë ndihmuar ushtrinë e Aleksandrit me mjete materiale, dhe e kamë ndërtoare një fushë për të ushtruar mundje, [Sofokliu vepra karakteret].

Në kohën e perandorisë Romake mundja fillon të aplikohet me të madhe, gjithashtu ajo zhvillohet në të njëjtat terrene, por me rregulla më të ndryshme nga ato të mundjes së lojërave të lashta olimpike.

Kjo formë e mundjes e kombinuar, quhej – mundje “greko-romake”. Format dhe teknikat e mundjes u aplikuan dhe u zhvilluan edhe gjatë organizimit të dyluftimeve të gladiatorëve nëpër arenat e njohura që ishin shumë të popullarizuara në mbarë territorin e perandorisë romake.

Forma tjetër e mundjes quhet mundja popullore, apo e njohur për opinionin tonë pehlivanët ose mundja e lirë. Kuptimi i nocionit apo termit pehlivan, në gjuhën turke është me këtë emër, kurse prejardhja është nga gjuha e vjetër perse PAHLIVAN, që në kuptim të gjerë do të thotë, NJERI I SHKATHËT, NJERI AKROBAT , NJERI I ZOTI, etj.

Fillet e para të pehlivanëve në trojet ballkanike, kanë prejardhjen nga perandoria osmane, që daton nga fillimi i shekullit të 15 - të. Gjithashtu edhe në trojet shqiptare kjo formë e mundjes popullore fillon të përhapet në të njëjtën kohë. Shënime të sakta rreth fillimit të kësaj forme paraqitjes të mundjes tek ne nuk ka. Në Kosovë ekipet e para të mundjes fillojnë të regjistrohen në vitin 1977, nga ajo kohë e deri më sot, pa ndërpre mbahen dhe zhvillohen garat e mundjes si; kampionatet shtetërore, dhe ato të niveleve ndërkombëtare. (3)

Në Evropë, që nga garat e para të lojërave olimpike moderne të vitit 1896, është përfshirë edhe mundja, dhe nga ajo kohë, sporti i mundjes përhapet në të gjitha vendet e botës. Sporti i mundjes ka organizime në të gjitha evenimentet garuese si; shtetërore, ballkanike, mesdhetare, evropiane, kontinentale, botërore dhe ato olimpike.

Mundja është sport, i cili bën pjesë në grupin e sporteve mundëse, aciklike polistrukturale, çka do të thotë se kemi të bëjmë me një numër shumë të madh të lëvizjeve, kapjeve dhe kombinimeve të pakufizuara, ngase është e lejuar që të kemi lidhje të, të gjitha pjesëve të ekstremiteteve dhe të trupit, dhe kur këto kombinohen del një repertuar shumë i begatshëm që sportin e mundjes e bën shumë atraktivë, dinamik dhe tërheqës.

Në dallim prej mundjes klasike, në mundjen e lirë, mundësi ka mundësi të përdor kapje si në pjesën e sipërme të trupit ashtu edhe në pjesën e poshtme të trupit, pra me të

dyja duart dhe te dy këmbët, kuptohet se aty përfshihen edhe beli dhe koka. Në mbarë boten mundja ka një zhvillim shumë të madhe, ku dhe shtetet më të mëdha bëjnë gara se kush do te ketë primat në këtë sport. (3)

Ne Kosove mundja ka filluar te zhvillohet ne vitin 1977, për herë të parë në Suharekë, e po të njëjtin vit edhe në Prishtinë. (2)

Nga ai vit, janë zhvilluar garat e kampionateve individuale dhe ato ekipore, dhe atë deri në vitin 1991, kur janë ndërprerë nga administrata e dhunshme e asaj kohe.

Periudha më e ndritshme e sportit të mundjes në Kosovë është koha e viteve më të ndritura të sportit të mundjes, e kjo i përket vitit 1982, kur për herë të parë në krye të udhëheqjes së mundjes kosovare vjen strategu i mirënjohur dhe me përmasa ndërkombëtare z. Mentas Allajbegu, që njëherazi ishte edhe trajner i KM Prishtina, nga Prishtina.

Në këtë kohë fillon të lulëzoj dhe të zhvillohet mundja kosovare me një ritëm të pa parashikuar. Pas kësaj, menjëherë vërehen rezultatet e punës së tij, si në kampionatet e ish Jugosllavisë dhe ato.

Gjatë kësaj periudhe u arritën edhe rezultate kulmore në arenën ndërkombëtare, këtu mund të veçohen rezultatet e sportistëve të mirënjohur si; Shaban Tërstena dhe Shaban Sejdiu të cilët fituan medalje nga kampionatet botërore dhe deri te Lojërat Olimpike.

2. HULUMTIMET E DERITASHME

Kohëve të fundit gjithnjë e më shumë është në rritje numri i punimeve nga autorë të ndryshëm në lidhje me karakteristikat morfologjike dhe aftësitë motorrike specifike, sepse këto janë parametra kyçe për arritjen e rezultateve jo vetëm në sportin e mundjes por edhe në shumicën dërmuese të sporteve. Ne do ti përmendim disa autorë të cilët kanë bërë studime në këtë aspekt: Në punimin e autorëve: G.Georgiev, S.Shala, L.Ibri: “Relations between motor abilities and the wrestler’s competitive effectiveness – 2011” Është aplikuar bateria e testeve prej 22 ndryshoresh, në një mostër prej 103 mundësash. Bateria e testeve përbëhet nga 17 teste për vlerësimin e aftësive motorike dhe 5 teste për vlerësimin e efektivitetit garues të mundësat. Nga analiza e rezultateve duke përdorur analizën e korrelacionit kanonik u tregua se faktorët kanonikë mund të interpretohen si një faktor i përgjithshëm motorik integral, ndërsa në strukturën e efikasitetit garues të mundësit; faktori kanonik mund të interpretohet si faktor i suksesit garues. Këto relacione sugjerojnë që mundësit me këto aftësi motorike mund të arrijnë rezultate shumë të mira në gara. Pra, për arritjen e rezultateve të mira dhe efikasitetit garues në mundje, janë të nevojshme aftësitë motorike cilësore. Në punimin e autorit: L.Ibri: Influence of anthropometric characteristics in manifestation of situational exercise at wrestlers – 2012” Është aplikuar bateria e testeve prej 14 ndryshoresh, në mostrën prej 103 mundësash. Bateria e testeve përbëhet nga 12 teste për të vërtetuar ndikimin e karakteristikave antropometrike në manifestimin e dy aftësive motorike specifike: koordinimi me dhe pa kukull (SKSABL) dhe hudhja e kukullës (SBACLU). Në bazë të rezultateve, është konkluduar se testi i kriterit - hudhja e kukullës (SBACLU), nuk ka asnjë lidhje statistikisht të vlefshme me ndryshoret antropometrike të mundësat. Gjithashtu, është konkluduar se testi kriter - koordinimi me dhe pa kukull (SKSABL), ka lidhje statistikisht të vlefshme me ndryshoret antropometrike. Autorët: P.Sahiti, L.Ibri, S.Shala, Sh.Shkelzen; në punimin e tyre “Razlike u antropometriskim karakteristikama i motorickim sposobnostima izmedju djecaka rvaca, fudbalera i nesportasa, kanë konkluduar se mundësat në krahasim me futbollistët dhe jo sportistët mes tyre kanë dallime të rëndësishme statistikore, Edhe në ndryshoret motorrike mundësat krahasuar me futbollistët dhe jo sportistët kanë dallime të teksuara.

3. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Zhvillimi dhe përparimi i sportit të mundjes viteve të fundit, kërkon nga hulumtuesit e kësaj fushe, përcjelljen dhe monitorimin e vazhdueshëm të statutit shëndetësor, zhvillimin e karkteristikave antropometrike dhe aftësive trupore, me qëllim preventiv të ndikimit të fekateve negative në organizmin e sportistëve.

Bazuar në numrin e subjekteve të cilët do të trajtohen në këtë punim, si dhe numrit të variablave përmes së cilave do të testohen subjektet e këtij eksperimenti, qëllimet dhe objektivat kryesore në këtë projekt do të përkufizohen në realizimin e këtyre qëllimeve:

Duke u nisur nga qëndrimet e paraqitura në qasjen e problemit dhe lëndës së hulumtimit, qëllimi është të konstatohet gjendja e karakteristikave morfologjike dhe aftësive motorike tspecifike, ndërsa Qëllimi kryesorë i hulumtimit është të vërtetohet dallimi ndërmjet mundësve të Kosovës dhe mundësve të Maqedonisë së Veriut në disa ndryshore morfologjike dhe ndryshore motorrike specifike.

Objektivat kryesore në këtë projekt do të përkufizohen në realizimin e këtyre qëllimeve:

- Vërtetimi i dallimeve në ndryshoret morfologjike në mes të mundësve të Kosovës dhe mundësve të Maqedonisë së Veriut.
- Vërtetimi i dallimeve në ndryshoret motorike specifike në mes të mundësve të Kosovës dhe mundësve të Maqedonisë së Veriut.
- Vërtetimi nëse ndryshoret morfologjike dhe motorike specifike do të kenë lidhmëri të rëndësishme në mes vete.

3.1. HIPOTEZAT E HULUMTIMIT

Në bazë të hulumtimeve të deritanishme të cilat kanë trajtuar strukturën e hapësirës morfologjike dhe asaj motorike si dhe në bazë të problemit, lëndës dhe qëllimit të hulumtimit, mundë të parashtrohen këto hipoteza:

- H1 - Supozoj se do të egzistojnë ndryshime të rëndësishme morfologjike në variablat e trajtuara ndërmjet subjekteve.
- H2 - Supozoj se do të ketë lidhshmëri të rëndësishme mes ndryshoreve motorike në variablat e trajtuara ndërmjet subjekteve.
- H3 - Supozoj se do të ketë lidhshmëri të rëndësishme mes ndryshoreve antropometrike dhe motorike te subjektet e trajtuar.
- H4 - Supozoj se do të egzistojnë ndryshime të rëndësishme morfologjike në variablat e trajtuara ndërmjet subjekteve.
- H5 - Supozoj se do të egzistojnë ndryshime të rëndësishme në aftësitë motorike në variablat e trajtuara ndërmjet subjekteve.

4. METODAT E HULUMTIMIT

4.1. MOSTRAT E ENTITETEVE

Mostrat e të hulumtuarve përbëhet nga 60 sportistë që aktivisht merren me sportin e mundjes dhe i përksin gjinisë mashkullore, të moshës 18-25 vjeçare, të ndarë në dy grupe. Grupin e parë (A) e përbëjnë 30 sportistë mundës nga Republika e Kosovës, kurse grupin e dytë (B) e përbëjnë 30 mundës nga Republika e Maqedonisë së Veriut, të cilët së paku 3 vjet, në mënyrë të rregullt janë marrë me sportin e mundjes. Në punim janë testuar mundësit, ku mosha e tyre sillet 18-25 vjeç. Të gjithë mundësit të cilët kanë qenë të sëmurë dhe ata të cilët kanë munguar me rastin e realizimit në ndonjërin nga testet e punimit janë eliminuar nga hulumtimi.

Kriteret themelore për testimin e popullatës:

- a) ndryshimet në moshë të mos jenë më të rinj se ± 6 muaj,
- b) së paku 3 vite të kenë qenë të rregullt në procesin e rregullt stërvitor,
- c) gjësë paku 2 herë të kenë qenë të pjesëmarrës në kampionatet e tyre shtetërore, përkatëse të Kosovës, përkatësisht të Maqedonisë së Veriut.
- ç) gjatë testimit të mos jenë të sëmur apo të lënduar,

4.2. MOSTRA E NDRYSHOREVE

Mostrën e ndryshoreve e përbëjnë dymbëdhjetë tregues morfologjik dhe pesë tregues të aftësive motorike specifike. Ndryshoret për matjen e ndërtimit morfologjik janë marrë nga Sistemi biologjik ndërkombëtar (IBP-Weiner & Lourie, 1969), ndërsa ndryshoret motorike janë marrë nga testet motorike të standardizuara evropiane për vlerësimin e aftësive lëvizore). Standardizimi i baterisë së testeve u bë nga Këshilli Evropian për të rritur i publikuar në vitin 1995.

4.2.1. MOSTRA E NDRYSHOREVE MORFOLOGJIKE

Testi morfologjik përmban këto tregues:

1.	Lartësia trupore	ALATR
2.	Pesha trupore	APETR
3.	Indi dhjamor i barkut	AIDHB
4.	Indi dhjamor i shpinës	AIDHSH
5.	Indi dhjamor i gjoksit	AIDHGJ
6.	Indi dhjamor i kërcit	AIDHP
7.	Perimetri i kërcit	APEPU
8.	Perimetri i kofshës	APEKO
9.	Gjatësia e krahut	AGJKR
10.	Gjatësia e këmbës	AGJKE
11.	Mosha	MOSHA
12.	Indeksi i masës trupore	BMI

4.2.2. MOSTRA E NDRYSHOREVE MOTORIKE SPECIFIKE

Testi motorik specifik përmban këto tregues:

1.	Kapërdimje para mbrapa	MKAPM
2.	Ura dhe kthimi në urë	MUKUR
3.	Piruetë në urë	MPIUR
4.	Koordinimi me dhe pa kukull	MKMPK
5.	Hudhja e kukullës	MHUKU

5. METODAT E PUNËS

5.1. KUSHTET, INSTRUMENTET DHE TEKNIKAT E MATJEVE

Para fillimit të procesit matës çdo mundësi i është dhënë verbalisht informatë për pikat matëse dhe nga ana e matësve është demonstruar pozita e qëndrimit gjatë matjes. Është treguar qëllimi i matjes, në mënyrë që mos të krijohet huti dhe panik gjatë procesit matës dhe që mundësit të jenë sa më të lirë dhe të vëmendshëm. Matja e masave morfologjike është bërë në palestrat e mundjes aty ku mundësit kanë zhvilluar procesin e rregullt stërvitor. Matjet janë bërë nga grupi i profesorëve të Kulturës Fizike, të cilat kanë pasur njohuri paraprake për teknikat e matjes. Fillimisht është bërë matja e parametrave morfologjik dhe atë nga ora 9.00 gjer në orën 11,00 në palestrat sportive të mundjes, vendi ku janë bërë matjet, kanë qenë mjaftë të ndriçuara dhe temperatura ka qenë në kufijtë e normales, prej 17 deri 22 C. Instrumentet kanë qenë të standardizuara dhe të bazhduara para fillimit të matjes si dhe gjatë matjes. Të ekzaminuarit kanë qenë këmbëzbathur të veshur vetëm në triko sportiv. Testet e ndryshoreve motorike janë kryer të nesërmen po në sallat e mundjes, ku janë bërë matjet. Të ekzaminuarit këto matje i kanë pritur me interesim të madh e sidomos testimin hedhja e kukullës.

5.1.1. MATJET E KARAKTERISTIKAVE ANTROPOMETRIKE

Për variablat e caktuara të masave morfologjike janë përdorur instrumentet matëse morfologjike sipas Martinit.

- Antropometri i Martinit, i cili na mundëson saktësinë e matjes prej 0,1cm;
- Peshorja, e cila na mundëson saktësinë e matjes prej 0,1 kg;
- Metri shirit, i cili na mundëson saktësinë e matjes prej 0,1cm;
- Kompasi rrëshqitës i cili na mundëson saktësinë e matjes prej 0,1cm;
- Kaliperi i cili na mundëson matjen e indi dhjamor nënlëkuror me saktësinë e matjes prej 1mm.



Testet motorike kanë janë vlerësuar me ndihmën e disa pajisjeve të domosdoshme me të cilat është bërë matja:

- Kronometri mekanik që mundëson saktësin e matjes prej 0,01 sek.
- Janë përdorur edhe kukulla për hudhje, shiriti ngjitës me ngjyrë, konët plastik, letër etj.

1. LARTËSIA E TRUPIT

Lartësia e trupit është matur me antropometër. Me rastin e matjes i eksperimentuari duhet të jetë i zbathur dhe të qëndrojë në bazë të fortë horizontale. Koka duhet të ketë atë pozitë ku arrihet horizontalja e Frankfurtit (skaji i poshtëm i syrit dhe skaji i epërm i zgavrës së jashtme të veshit të jenë në pozitë horizontale). Qëndrimi i trupit duhet të jetë i drejtë, shputat e bashkuara dhe i ulur në karrigë. Eksperimentuesi qëndron në të majtë të të eksperimentuarit, pasi që kontrollon pozitën e tij dhe vendosjen e instrumentit, lëshon horizontalen e antropometrit deri në pjesën parietale të kokës. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.



2. PESHA E TRUPIT

Mënyra ideale për të matur peshën e trupit është peshorja me rreze e tipit të balancuar me saktësi afër 0.1 kg. Subjekti duhet të matet i veshur vetëm në brekë. Pasi që pesha gjatë ditës ndryshon është mirë që subjekti të matet para dreke, nëse do të ketë më shumë se një matje. Vlerat më stabile për të monitoruar ndryshimet e peshës janë ato që janë bërë në mëngjes. Peshorja duhet të gradohet (kalibrohet) në shifrën zero para se subjekti të hip mbi te pa kurrfarë mbështetje, pesha e trupit duhet të shpërndahet në qendër të peshores, duke shikuar drejt para, përderisa të regjistrohet pesha nga matësi.



3. INDI DHJAMOR I BARKUT:

Indi dhjamor i barkut, matet me instrumentin e quajtur kaliper që tregon saktësi prej 1mm. Subjekti qëndron në pozitë të drejtkëndrimit, me krah të drejtë, përball trupit të matësit dhe i relaksuar. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues kapë masën e indit dhjamor të barkut (në lartësinë e kërrhizës dhe rreth dy cm., larg sajë) afër gishtave e vendos kaliperin. Rezultati lexohet me saktësi prej 1mm., dhe shënohet në fletëtestim.



4. INDI DHJAMOR I SHPINËS:

Indi dhjamor i shpinës, matet me instrumentin e quajtur kaliper që tregon saktësi prej 1mm. Subjekti qëndron në pozitë të drejtkëndrimit, me krah të drejtë, me shpinë ka trupi i matësit dhe i relaksuar. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues kapë masën e indit dhjamor të shpinës në diagonale poshtë shpatullës dhe afër gishtave e vendos kaliperin. Rezultati lexohet me saktësi prej 1mm., dhe shënohet në fletëtestim.



5. INDI DHJAMOR I GJOKSIT:

Indi dhjamor i gjoksit, matet me instrumentin e quajtur kaliper që tregon saktësi prej 1mm. Subjekti qëndron në pozitë të drejtkëndrimit, me krah të drejtë, përball trupit të matësit dhe i relaksuar. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues kapë masën e indit dhjamor të gjoksit, (në lartësinë nën brinjën e dhjetë dhe pikës papilla mama) dhe afër gishtave e vendos kaliperin. Rezultati lexohet me saktësi prej 1mm., dhe shënohet në fletëtestim



6. INDI DHJAMOR NË KËRCI:

Indi dhjamor nënlëkuror nën kërci, matet me kaliper që tregon saktësi prej 1mm. Subjekti qëndron përball trupit të matësit, në pozitën e ulur dhe i relaksuar, ashtu që këmba e tij është e mbledhur në nyjen e gjurit, gishtat e këmbës së tij janë të vendosura në takim me tokën, kurse thembra është e ngritur krah lartë,. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues kapë masën e indit dhjamor të pulpës, (në pjesën më zgjeruar të pulpës) dhe afër gishtave e vendos kaliperin. Rezultati lexohet me saktësi prej 1mm., dhe shënohet në fletëtestim

7. PERIMETRI I KOFSHES

Perimetri i kofshës matet me shirit milimetrik. Subjekti qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, me këmbë diç të largura, me krah të lëshuar përball matësit dhe i relaksuar. Shiriti matës vendoset duke embështjellë horizontalisht rreth këmbës së majtë nën lugun gluteal, vendi më i gjerë i kofshës. Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1 cm.

8. PERIMETRI I KËRCIT

Perimetri i kërcit matet me shirit milimetrik. Subjekti qëndron përball matësit, në pozitë të drejtqëndrimit, me këmbë diç të largura, me krah të lëshuar dhe i relaksuar. Shiriti matës vendoset në të tretën e lartësisë së kërcit duke embështjellë horizontalisht rreth këmbës së majtë te vendi më i gjerë i kërcit. Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1 cm..

9. GJATËSIA E KRAHUT:

Gjatësia e krahut matet me antropometër. Subjekti qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, me krah të lëshuar, bri trupit testmatësit dhe i relaksuar. Antropometri i krahut vendoset nga pjesën krista iliaka e krahut deri te gishti i gjatë i mesëm i shuplakës. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1cm., dhe shënohet në fletëtestim.

10. GJATËSIA E KËMBËS:

Gjatësia e këmbës matet me antropometër. Subjekti qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, sikurse në matjen e lartësisë trupore. Matja bëhet nga dyshemeja ku qëndron i eksperimentuari deri në pikën e quajtur “gjembi i sipërm i përparmë i çapokut” (spina iliaca anterior superior) të anës së majtë, e cila caktohet me gishtin e mesëm të dorës që mban pjesën horizontale të antropometrit. Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1 cm.

11. MOSHA E SPORTISTIT:

Mosha e sportistit përcaktohet me verifikimin e lërnjoftimit apo librezës garuese të sportistit, ku me saktësi shenohet data, muaji dhe viti i lindjes. Sportistët që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe ata të cilët në tri vitet e fundit nuk kanë marrë pjesë në kampionatet përkatëse shtetërore nuk mund të marrin pjesë në këtë projekt dhe nuk do të testohen. Mosha shenohet me saktësi në fletëtestim.

11. INDEKSI MASËS TRUPORE (BMI):

Përfshinë peshën trupore dhe gjatësinë trupore. BMI është shkurtesa ndërkombëtare për Indeks të masës trupore dhe ajo llogaritet në këtë mënyrë:

$BMI = \text{Pesha trupore} / \text{gjatësinë trupore} \times \text{gjatësinë trupore}$

Shembull: njeri me peshë 86 kg dhe gjatësi 180 cm. $BMI = 26.54$

BMI me parametrat normal është prej 18.5 der 24.9

5.1.2.. MATJET E KARAKTERISTIKAVE MOTORIKE

1. KAPËRDIMJE PARA, PRAPA:

I testuari qëndron i përgatitur në dyshekë. Në shenjën e matësit “gati”, i testuari përgatitet për fillimin e testit, në shenjën “tash” urën kapërdimjen



para, vendos duart në dyshek në gjerësi të supeve, kokën e futë brenda në mes të duarve, takon me shpinë në dyshek, rrotullohet dhe ngritët, kthehet për 180° shkallë, ulet poshtë, bije në shpinë, duart i vendosë pranë kokës, afron këmbët, rrotullohet dhe ngrihet në këmbë, (ky është një cikël i testit. I testuari fillon të kryej testin në mënyrë sa më korrekte, duhet të përpiqet që ciklet t'i kryej sa më shpejt që të ketë mundësi brenda kohës prej 30 sekondash. Rezultati, merret për bazë numri i saktë i cikleve dhe shënohet me saktësi në listën e testeve. Koha matet me kronometër, nga momenti i fillimit të testit e deri në përfundimin testit.

2. URA DHE KTHIMI NË URË:

I testuari qëndron i përgatitur në dyshekë. Në shenjën e matësit “gati”, i testuari bën urën e mundjes, shtrihet dhe ngritët në



urë, duke qëndruar me kokë dhe me shputa, dhe duke u mbajtur me duar afër kokës si dhe duke e ngritur trupin sa më lartë. I testuari fillon të kryej testimin (urat) në mënyrë sa më korrekte, me këmbë shtytet dhe kalon këmbët mbi trupin e tij para, menjëherë shtytet dhe përsëri kalon këmbët mbi trupin e tij prapa, në pozitën fillestare (ky është një cikël). I testuari duhet të përpiqet që urat t'i kryej sa më shpejt që të ketë mundësi për kohën prej 30 sekondash. Rezultati (merret për bazë numri i saktë i urave) dhe shënohet me saktësi në listën e testeve. Koha matet me kronometër, nga momenti i fillimit të testit e deri në përfundimin testit.

3. PIRUETË NË URË:

I testuari qëndron i përgatitur në dyshekë. Në shenjën e matësit “gati”, i testuari bën urën e mundjes, shtrihet dhe ngritët në urë,



duke qëndruar me kokë dhe me shputa, duke u mbajtur me duar afër kokës dhe duke e ngritur trupin sa më lartë. I testuari fillon të kryej testimin (piruete në urë) në mënyrë sa më korrekte, me këmbën e djathtë shtytet dhe kalon këmbën nga ana e majtë mbi trupin e tij, pastaj kalon këmbën e majtë duke u sjellur në piruete dhe vije në pozitën fillestare (ky është një cikël). I testuari duhet të përpiqet që ciklet t’i kryej sa më shpejt që mundet për kohën prej 30 sekondash. Rezultati, merret për bazë numri i saktë i cikleve dhe shënohet me saktësi në listën e testeve. Koha matet me kronometër, nga momenti i fillimit dh e deri në përfundimin testit.

4. KOORDINIMI ME DHE PA KUKULL:


I testuari qëndron i përgatitur në dyshekë. Në shenjën e matësit “tash” i testuari vrapon deri te kukulla që gjendet 1m, larg tij, merr kukullën dhe me hedhje nga lartë e hedhë atë mbi brezin e tij, nga mbrapa, këtë e hedhje e përsëritë deri në fund të dyshekëve, në largësi 5m, e lë kukullën dhe



fillon të bëj ura nga brapa në lëvizje deri në skajin tjetër të dyshekut në largësi prej 5m, kthehet dhe shtrihet, ashtu fillon të rrotullohet në drejtim të cakut, deri te caku, përfundon testin dhe ngritët në këmbë. Matja bëhet me kronometër, fillon nga shenja “tash” e deri te përfundimi i testit. I testuari kryen testimin në mënyrën sa më korrekte dhe sa më shpejt që mundet. Nëse i testuari nuk e kryen njërin element si duhet, do të kthehet për ta kryer atë element, pastaj mund të vazhdoj detyrën. Rezultati shënohet me saktësi prej 0.1 sekonda.

5. HUDHJA E KUKULLËS NGA LARTË:

I testuari qëndron i përgatitur në dyshekë së bashku me kukullën duke e mbajtur atë para vetes. Në shenjën e matësit, i



testuari fillon të kryej testimin sa më shpejtë që të jetë e mundur, të hudhë kukullën për 15 herë. Kukulla mbahet, mbërthehet në pjesën e sipërme me dy duar dhe hudhet mbrapa mbi trupin e brezin dhe trupin e të testuarit. Pas secilës hedhje i testuari kthehet në pozitën fillestare. Pas hudhjes së pesëmbëdhjetë i testuari ngritët në këmbë pa kukull. I testuari duhet të përpiqet që hedhjet t'i kryej sa më shpejt që ka mundësi. Rezultati shënohet me saktësi prej 0.1 sekonda. Koha matet me kronometër, nga momenti i fillimit deri në përfundimin e hedhjes së pesëmbëdhjetë.

5.2. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në bazë të qëllimit të parashtruar është zgjedhur edhe metodologjia e përpunimit të rezultateve:

Parametrat themelorë statistikorë:

- Rezultati minimal,
- Rezultati maksimal,
- Mesatarja aritmetike,
- Devijimi standard,
- Gabimi i mesit aritmetik,
- Simetria e distribucionit (Skew)
- Shtrirja e distribucionit (Kurt)
- Korrelacioni (Pearson)

Parametrat tjerë statistikorë (analizat):

analiza e rezultateve përmes t – testit .

Në brendësin e t- testit shtë llogaritur krahasimi i ndryshoreve të mesatareve aritmetike mes grupeve::

- Krahasimi i ndryshoreve të mesatareve aritmetike morfologjike mes grupit GA, mundësve nga Kosova dhe grupit GB, mundësve nga Maqedonia e Veriut,
- Krahasimi i ndryshoreve të mesatareve aritmetike të aftësive motorike specifike mes grupit GA, mundësve nga Kosova dhe grupit GB, mundësve nga Maqedonia e Veriut,

6. REZULTATET DHE DISKUTIMI

6.1. PARAMETRAT THEMELORË STATISTIKORË

6.1.1. Analiza e parametrave themelorë të ndryshoreve morfologjike - GA

Tabela 1. Parametrat themelor statistikorë të karakteristikave morfologjike – GA

